

Skender Rizaj

## KOSOVA NË DISA DOKUMENTE ANGLEZE (1881 — 1885)

Kosova gjatë viteve 1881—1885 ka përjetuar ngjarje të bujshme. Kështu, në fillim të vitit 1881, Lidhja Shqiptare e Prizrenit korri suksese të mëdha. Pastaj nga prilli i vitit 1881 e deri kah mesi i vitit 1885 Lidhja Shqiptare e Prizrenit zhvilloi një luftë të rreptë kundër rivendosjes së pushtetit osman në viset e Kosovës. Këtë e vërtetojnë edhe këto 15 dokumente angleze, të cilat po i prezentojmë si vijon.

1. Në janar të vitit 1881, 35.000 shqiptarë mblidhen në Prizren dhe në rrethinën e tij, me qëllim që ta çlirojnë Ulqinin.

2. Shqiptarët rreth e përqark Gjakovës dhe Pejës përgatitën pusi kundër Dervish pashës (qershor 1881).

3. Dervish pasha i vendosi batalionet e mëdha këmbësore dhe bateritë e artilerisë në të gjitha qytetet e Velajetit të Kosovës (Prizren, Gjakovë, Pejë, Prishtinë, Mitrovicë, Shkup) me qëllim që t'i nënshtrojë shqiptarët kryengritës dhe shumë udhëheqës të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit i internoi për në Anadoll (qershor 1881).

4. Shenja të trazirave të mëdha duken përsëri në Shqipërinë Veriore, posaçërisht në rrethin e Pejës, të Gjakovës dhe të Dibërës (gusht 1881).

5. Malësorët shqiptarë të Pejës dhe të Gjakovës ishin marrë vesh për të mbajtur një qëndrim kërcënues, e prej disa viseve, siç ishte rasti i Rekës (nahije e madhe në kazanë e Gjakovës) i përzu në me forcë zyrtarët turq, të cilët duheshin të kryenin detyrën e regjistrimit të popullsisë (shtator 1881).

6. Nga kazaja e Gjakovës, e Pejës, e Gucisë, e Beranës dhe e Tërgovishtës (Rozhaja) u formua Sanxhaku i Pejës me Ali pashë Gucinë në krye (tetor 1881).

7. Dervish pasha marshoi prej Prizreni për në Dibër në krye të 20 batalioneve, me qëllim që edhe atje t'i nënshtrojë shqiptarët (tetor 1881).

8. Ali pashë Guçia dhe Hasan pashë Tetova u nisen për në Stamboll me qëllim që t'i bëjnë nderime Lartëmadhërisë së Sulltanit (tetor 1881).

9. Shumë çeta cubash shqiptare e bullgare (maqedone — S. R.) e rrethuan kazanë e Shkupit, të Prishtinës, të Gilanit e të Kumano-vës (shkurt 1882).

10. A. Evans thotë se në korrik të vitit 1883 Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk ishte aktive, por kishte prova të qarta të vazhdimit të lëvizjes, për çka kjo ishte një simptomë.

11. Dërgimi i shpejtë i ushtrisë plotësuese osmane në Prizren, në fillim të marsit të vitit 1885, shkaktoi shumë shqetësime si dhe ngjalli dyshime, në mes të tjerash, se shqiptarët në Prizren ishin ngritur në kryengritje të haptë.

12. Duket se me përdorimin e forcës u shtypën shqiptarët dhe së Porta njëmend kishte vendosur të mbajë rregull dhe qetësi (mars 1885).

13. Kryengritësit shqiptarë më 1 mars 1885 u përpoqën ta push-tojnë Prizrenin, por ata i dëboi ushtria e garnizonit osman, të cilën e komandonte Ibrahim pasha. Pas një përleshjeje të ashpër, e cila zgjati pesë orë, u vranë dhe u plagosen 300 veta.

14. Qetësia lindi në Prizren nga fakti se malësorët shqiptarë pjesën më të madhe të municionit të vet e kishin shpenzuar për armët me predha dhe se besimi i përgjithshëm në fuqinë e Qeverisë Osmane për të mbajtur rregull aq shumë është tundur sa që zejtaria dhe tregtia ishin pezulluar plotësisht në mbarë Vilajetin e Kosovës (mars 1885).

15. Vejsel pasha i arrestoi dhe i internoi për në Azi të Vogël udhëheqësit kryesorë të trazirës së fundit dhe pati sukses t'i detyrojë shqiptarët që të rekrutohen për ushtri dhe t'i mbledhë taksat e paguara për Qeverinë Osmane (gusht 1885).

## 1. ZOTËRI St. JOHN KONTIT GRANVILLE

(Telegrafik)

(Ekstrakt)

Stamboll, 15 janar 1881, 6<sup>h</sup> p.d.

Në lidhje me shkresën Tuaj sekrete No. 4 të dt. 6 të këtij muaji.

Përsa i përket Shqipërisë, dëgjova personalisht, nga një vendas i krishter i atij vendi, i cili është duke ushtruar detyrë të lartë osman,\* se 35.000 shqiptarë janë mbledhur në Prizren dhe rrethi-

\* Ky krishter shqiptar, me post të lartë osman, duhet të ketë qenë Vaso efendiu (Pashko Vasa), i cili, njëherë, ushtronte detyrën e zëvendësit të valiut të Vilajetit të Kosovës (1877—1879), e pastaj të Vilajetit të Edrenës (1879—1883).

nën e tij qëllimi i të cilëve është që ta çlirojnë Ulqinin; e Ali pashë Guçia është urdhëruar që të komandojë me ta.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/110*, pp. 25)

## 2. ZOTËRI K. GREEN KONTIT GRANVILLE

Im Lord,

Shkodër, 6 qershor 1881

Një njeri i cili është njohës i mirë i ngjarjeve më njohtoi se Dervish pasha, tashmë, e la me nxitim Pejën, dhe, nëpërmjet të një rruge, e cila, thuajse, nuk përdoret, shkoi për në Prizren.

Im informator më tha se Ali pashë Guçia kishte marrë vesh se malësorët rreth e përçark Gjakovës dhe Pejës ishin duke përgatitur pusi kundër Dervish pashës. Prandaj, frikësohej se ata mund ta sulmonin haptazi gjeneralin. Për këtë arsye, ai (Ali pashë Guçia) ia mbushi mendjen atij (Dervish pashës) që ta braktisë menjëherë Pejën, dhe, siç u tha, ta ribashkojë masën e ushtrisë së vet në Prizren.

Brenda disa ditëve të fundit jam njohtuar me ma shumë sekrete, të cilat qarkullojnë në disa qarqe shqiptare, të cilët me shtyjnë të besoj se u shua efekti i parë i sukseseve të Dervish pashës, dhe se atë (Dervish pashën) mund ta gjejë i njëjti fat i Mehmet Ali pashës. Ndërkaq, mendoj se Dervish pasha, nuk duket se do ta humbë lehtë zotërimin e fituar mbi shqiptarët, si dhe përpjekjet e pandërprera për t'i kundërshtuar kundërshtarët e autoriteteve osmane.

Kam nderin, etj.

(Nënshkruar) W. KIRBY GREEN.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/115*, pp. 16, 17; *F. O. 195/1367*).

## 3. KONSULLI I PËRGJITHSHËM BLUNT KONTIT GRANVILLE

Im Lord,

Selanik, 14 qershor 1881

Mësova nga njërëzit, të cilët, tani vonë, e vizituan Prizrenin, dhe nga burimet e tjera sekrete, se Dervish pasha po ndjek një politikë të matur dhe të butë ndaj udhëheqësve shqiptarë, të cilët duket se janë hutuar me operacionet e tij të fundit të marra kundër Lidhjes. Ata shohin qartë se fuqia e Qeverisë së Sulltanit është ajo që po i ndëshkon; dhe se nuk ka gjasa që ata do ta ringjallin apo do ta nxisin kryengritjen në të ardhmen.

Dervish pasha, tani vonë, e vizitoi Gjakovën dhe Pejën dhe me atë rast pati sukses që atje ta përtërijë pushtetin civil.

Malësorët e Gjakovës, trazimtarët më të mëdhej nga klanet shqiptare, të gegërisë, u nënshtruan dhe u zotuan se do të regrutohen për ushtri, regrutim ky, siç thanë informatorët e mi, tani po kryej atje pa zhurmë si në Pejë dhe në Prizren, ashtu edhe përgjithësisht në të gjitha viset e Vilajetit të Kosovës. Afro 550 regrutë shqiptarë u zgjodhen dhe u dërguan për në armatë. Mbramë 230 regrutë arritën nga Prizreni, të cilët, sot, do të transferohen me anijet turke për në Dardanele dhe në Stamboll.

Taksat qeveritare, tani, po ashtu, janë mbledhur me rregull, e prijatarët malësorë më me zë premtuan bashkëpunimin e tyre me autoritetet e Portës për ta kryer regjistrimin me rregull të popullsisë, me qëllim të klasifikimit të popullsisë për shërbim ushtarak, sipas moshës së tyre dhe aftësisë dhe për të vlerësuar terësisht taksat për dele dhe të ashtuquajturën „vergi”,\* dy masa të cilat autoritetet e vilajetit, deri më tani, kurrë nuk kanë mundur t'i sëndërtojnë me sukses në Shqipërinë Veri-lindore.

Dervish pasha tani është duke u përgatitur për të intervenuar në Dibër dhe në Mat, me qëllim që ato krahina t'i rregullojë ri-shtas.

Prizreni është okupuar tani prej dhjetë batalioneve këmbësorësh, me dy bateri të artilerisë, dhe prej gjysmë regjimenti të kalorësisë. Pushteti civil ia ka besuar Ferik Mehmet pashës, i cili është duke u marrë me punë të rivendosjes së pushtetit, nën mbikëqyrjen e Dervish pashës, në degët e ndryshme të administratës lokale.

Gjakovën e okupojnë tetë batalione këmbësorësh, 2 bateri të artilerisë, dhe një skuadër (njësi kalorësie e përbërë prej dy a më shumë kompanish) kavalerie, nën komandën e Ferik Musa Qazim pashës, i cili, njëkohësisht, e ushtron edhe postin civil.

Në Pejë janë të stacionuara tri batalione këmbësorësh, 1 bateri e artilerisë, dhe 1 skuadër e kavalerisë; Ferizajin e okupojnë 2 batalione këmbësorësh, Prishtinën — 2 batalione, Shkupin — 1 batalion, Dibrën — 2 batalione, Mitrovicën — 3 ose 4 batalione këmbësorësh dhe 1 bateri të artilerisë. Kurse teprica e armatës së Dervish pashës është vendosur në kufirin bullgar dhe serb.\*\*

Masa më e rëndësishme, të cilën Dervish pasha duhet ta ndër-marrë në Vilajetin e Kosovës dhe e cila me të madhe do të kontribojë në sigurimin e banorëve të krishterë, dhe në vendosjen e qetësisë së përgjithshme në vend, është ndalimi rreptësisht i të mbajturit të armëve.

Vice-konsulli austriak në Shkup, i cili këto ditë e vizitoi Selanikun, më siguroi se kjo masë politike e rreptë, e cila është duke u zbatuar në Sanxhakun e Shkupit, tashmë ka sjellë rrënjën e krim-it dhe të anarkisë; dhe njëri nga informatorët e mi, i cili arriti

\* Vergi ishte tatimi i cili vlej për arkën shtetërore.

\*\* Nën komandën e Ferik Ahmet Hivzi pashës, vali i Vilajetit të Kosovës, dhe Tahir pashës, mytesarrif i Sanxhakut të Shkupit.

këtu mbrëmë nga Prizreni, m'i tregoi rastet e masave imponuese të Dervish pashës, të cilat janë:

Me 8 të këtij muaji një shqiptar i Prizrenit, një kriminel i vjetër, Jusufi, i biri i Rrustemit,\* u gjet nga policia duke bredhur nëpër qytet, i pajisur me armë. Ai refuzoi të dorëzohej dhe, para se të zihej, shtiu në njërin nga policët. Ai, menjëherë, u nxor para gjykatës ushtarake, u dënua me vdekje, dhe, në mengjes, u ekzekutua publikisht në treg.

Me të gjithë udhëheqësit (shqiptarë), të cilët iu nënshtroan Dervish pashës dhe bashkëpunuan me autoritetet (osmane) në qetësimin e vendit, Shkëlqesia e tij (Dervish pasha) u soll miqësisht, i cili, siç thuhej, disa prej tyre ia kishte rekomanduar Portës për t'i futur në shërbime (pozita) të administratës së vilajetit.

Vetëm numri i kufizuar i të arrestuarëve ka mbetur në Prizren d. m. th. kanë mbetur ata që me armë e rezistuan Qeverinë e Sulltanit, ose e identifikuan veten me Lidhjen; e meqë shumica prej tyre i mbajnë emërimet krahinore kur ata iu bashkuan Lidhjes, Dervish pasha është i gatshëm të japë një listë të udhëheqësve kryengritës dhe tradhtarë, të cilët janë:

Shain aga, anëtar i Qeverisë së fundit (të Lidhjes) të Prizrenit; Mehmet efendiu kontabilist i Qeverisë së fundit (të Lidhjes) të Prizrenit; haxhi Jonuz efendiu, po ashtu nga Prizreni; Abdyl efendiu, ish myfti; Mehmed aga, ish shef i policisë në Shkup; Rauf efendiu, ulema nga Tetova; Abdyl be Frashëri, udhëheqës nga Epiri.

Njëri nga anëtarët më me ndikim dhe më aktiv i Lidhjes së Prizrenit, haxhi Ymer efendiu, pat sukses për të ikur në Ulqin. Familja e tij e përbërë nga bashkëshortja dhe tre fëmijë, u dërgua në Selanik, dhe ajo gjendet nën mbikëqyrjen e policisë.

Përveç të arrestuarve në Prizren, edhe një pjesë e parisë shqiptare-toskë të dyshuar për lidhjet e tyre me Lidhjen kundër autoritetit të Sulltanit, tani vonë, u arrestua në Epir dhe në Maqedoni, dhe, me urdhërin e Dervish pashës, u dërgua për në Dardanele. Emrat e tyre janë:

Pertev efendiu, kajmekam i fundit i Karaferisë, Mustafa beu, mytesarrif i fundit i Dramës në Maqedoni, Mustafa pasha nga Vlora; Ymer be Vrioni nga Berati, Mustafa beu nga Janina, Qazim beu, mytesarrif i Prevezës, Sylejman Dino nga Paramythia: të gjithë nga Epiri.

Nga të përmendurit, Qazim beu, Mustafa beu, Sylejman Dino, dhe Pertev beu, janë kushërinj të afërt të Abedin pashës, Ministër i fundit i Punëve të Jashtme (të Perandorisë Osmane); dy prej të cilëve i kishte emruar ai, kur ishte vali i Selanikut, në poste me rëndësi në Maqedoni, d.m.th. Mustafa beu për mytesarrif të Dramës, dhe Pertev beu për kajmakam të Karaferisë (Veria).

Po ashtu dëgjova, nga korrespondenca sekrete, e cila gjendet në zotërim të Abdyl Frashërit, se, siç duket, të gjithë personat e

\* Sigurisht është fjala për ndonjë vrasës të organeve të pushtetit osman.

lartpërmendur ishin, pak a shumë, të angazhuar si udhëheqës akti vë dhe nxitës për ndarjen e Shqipërisë Veriore dhe Jugore nga pushteti osman, dhe për themelimin e tyre në dy principata nën princa të ndarë.

Nuk mund të them sa mund të besohet në informatën, të cilën e paraqita në këtë shkresë. Pjesa më e madhe e saj është marrë nga burimet personale dhe papërgjegjësi, por disa prej këtyre informatave janë vërtetuar hollësisht nga kolegët e mi të huaj dhe opinioni publik këtu (në Selanik) në përgjithësi pohon se Dervish pasha, siç duket, e shkatërroi qeverisjen e Lidhjes, dhe i shtyri shqiptarët të besojnë në mossuksesin e Lidhjes.

Nëse është ashtu, Porta tani mund ta shfrytëzojë këtë si rast të përshtatshëm për konsolidimin e autoritetit dhe prestigjit të Sulltanit për zotërimin e reformave të rekomanduara nga Komisioni Evropian sipas artikullit 23 të Marrëveshjes së Berlinit.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkrimi) J. E. Blunt.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/115*, pp. 26, 27.)

#### 4. KONSULLI I PËRGJITHSHËM BLUNT KONTIT GRANVILLE

Im Lord,

Selanik, 13 gusht 1881

U njohtova nga dy njëjërëz, të cilët, tani vonë, vizituan Shkupin dhe Prishtinën, se, atje, në Shqipërinë Veriore, duken simptomat e trazirave të mëdha, posaçërisht në rrethin e Pejës, të Gjakovës dhe të Dibrës.

Duket se regjistrimin e popullsisë, siç urdhëroi Dervish pasha, e kundërshtuan banorët me tërë fuqinë dhe janë duke u ngritur në kryengritje në shumë krahina.

Në të vërtetë, informatorët e mi më siguruan se përpjekjet e Dervish pashës, për të qetësuar vendin, i pengoi fryma e fshehtë e revoltit të banorëve, revolt ky i cili mund të shpërthejë haptas përsëri sapo të paraqitet rasti i parë i përshtatshëm.

S'kam mjet për të vërtetuar sa është e saktë informata e sipërme, por situata në Shqipërinë Veriore nuk është krejtësisht e kënaqme, e cila shihet prej disa masave të vërtetuara nga Proklamata e fundit e Dervish pashës, kopja e përkthimit të së cilës i është bashkuar shkresës, proklamata kjo e cila i është drejtuar shqiptarëve lidhur me përpjekjet për t'iu shmangur regjistrimit të popullsisë, si dhe nga kërkesa që, si të themi, Shkëleqesia e Tij ia ka dërguar Portës, me telegram, se disa trupa ushtarake, që duhej të largoheshin nga Thesalia, të dërgohen për në Prizren e Dibër.

*Bashkangjitse**Proklamata e Dervish pashës, kryekomandant i forcave perandorake*

(Përkthim)

Kur Lartëmadhëria e Sulltanit dha urdhërin e tij të shkëlqyeshëm që regjistrimi i banorëve të kryhet në gjithë popullsinë myslimane dhe jomuslimane të Shqipërisë së Epërme, si këtu ashtu dhe gjetiu, u bë çmos që dëshirat perandorake të zbatohen në atë mënyrë që mbarë popullsia të regjistrohet pa përjashtim. Mirëpo, kam kuptuar se disa njerëz, në aspektin intelektual janë të paaftë për të çmuar rëndësinë dhe përmbajtjen e një ndërmarrjeje të tillë (siç nënkuptohet me anë të kësaj), dhe duke harruar krejtësisht pozitën e tyre të përlulët dhe detyrat të cilat, si nënshtetas të sinqertë dhe besnikë, janë të obliguar t'i kryejnë, ata, përkundrazi, për inat të urdhërave perandorake refuzuan t'i regjistrojnë emrat e vet dhe të anëtarëve të tjerë të familjes në regjistrin e popullsisë, dhe të njëjtit, me qëllim që t'i shmangen regjistrimit, tani janë duke u fshehur.

Meqenëse, atëherë, zbulimi i njerëzve të tillë është për t'u konsideruar si vepër lavdëruese, unë me anë të kësaj lajmëroj publikisht se prej tani, duke filluar nga paraqitja e kësaj Proklamate, çdo njeri, i cili u jep informata sekrete zyrtarëve kryesorë të zënë me punën e regjistrimit të popullsisë, lidhur me ekzistencën e individëve, të cilët janë duke u orvatur t'i shmangen regjistrimit, do të shpërblehet me nga 100 piastra (groshë) për çdo person të zbuluar, njërezit e fshehur të të gjithë informatorëve të tillë pa marrë parasysh se kush janë, do të vështrohen me rigozitet.

Prizren, 27 korrik 1881.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/118*, pp. 6.)5. KONSULLI I PËRGJITHSHËM BLUNT KONTIT  
GRANVILLE

Im Lord,

Selanik, 12 shtator 1881.

Kam nderin t'i raportoj Zotërisë Tuaj mbi lajmin, të cilin e kam marrë nga një burim i saktë, lidhur me situatën e çështjeve në Prizren dhe në krahinat shqiptare përreth.

Regjistrimi i popullsisë është bërë pa kundërshtim në qytetet dhe në krahinat e Shkupit, të Tetovës, të Kaçanikut, të Prishtinës, të Mitrovicës dhe të Prizrenit; por këto masa ende nuk janë zbatuar në krahinat e Dibrës së Poshtme dhe të Epërme, e sidomos në krahinat

e Pejës dhe të Gjakovës. Malësorët shqiptarë të këtyre krahinave janë marrë vesh për të mbajtur një qendrim kërcënonjës, e disa vise, siç ishte rasti i Rekës, nahije e madhe në kazanë e Gjakovës, ata i përzunë me forcë zyrtarët turq, të cilët duhej ta kryenin detyrën e regjistrimit të popullsisë.

Sipas informatorit tim në krahinat e Dibrës mbretëron një anarki e madhe dhe meqë autoritetet osmane nuk bënë asnjë përpjekje serioze për të rivendosur administrimin e tyre, malësorët e pabindur, bëjnë kërdi në fshatrat krishtere pa u dënuar, dhe banorët e qetë vazhdimisht po i mbajnë në gjendje lemeritëse.

(...)

Para afro gjashtë javësh, një turmë e madhe e atyre malësorëve nga nahija e Reçës, në Dibrën e Poshtme, u mësy në krahinën e Tetovës dhe plaçkiti 200 krerë gjedhë dhe 1.000 dele nga fshati Gostivar; dhe, pothuajse, në të njëjtën kohë, turma tjetër nga nahija Kalis, në Lumë, zbriti në rrafshira dhe mori më se 7.000 dele.

Nga të gjithë kam dëgjuar se Dervish pasha me ngurrim të madh është duke e përdorur armatimin, dhe është duke u përpjekur t'i nënshtrojë malësorët duke i përfituar bajraktarët e tyre, të cilët janë dinakë aq sa është edhe ai vetë (Dervish pasha) si dhe shumë pak u besojnë premtimeve të tij.

Nga ana tjetër, Dervish pasha nuk mund të mbështetej shumë në forcat ushtarake, të cilat ishin të përbëra pothuajse krejtësisht nga redifët (rezervistët), kryesisht nga Anadulli, që bërtitnin me zë të lartë për t'u kthyer në shtëpitë e veta, sepse sipas urdhërit, redifët duhej të shpërndaheshin në Maqedoni, në Thesali dhe në Epir. Mora vesh tani se janë bërë planet për t'i lëshuar këta trupa të ushtrisë, të cilët do të zëvendësohen nga batalionet nizamë (ushtri e rregullt) që do të shpëputen nga armata në Epir.

Prej 24 batalioneve këmbësorësh nën komandën e Dervish pashës, 18 sish janë redifë. Këto forca janë të shpërndara si vijon:

7 batalione — në Prizren, 10 batalione — në Gjakovë e Pejë, 3 batalione — në Lumë, 3 batalione — në Dibër, dhe një batalion — në Ferizaj.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/118*, pp. 43.)

## 6. KONSULLI I PËRGJITHSHËM BLUNT KONTIT GRANVILLE

Im Lord,

Selanik, 4 tetor 1881

Kam nderin ta njohtoj Zotërinë Tuaj se Porta, në bazë të sugjerimit të Dervish pashës, ka urdhëruar që nga kazaja e Gjakovës, e Pejës, e Gucisë, e Beranës dhe e Tërgovishtës (Rozhaja) të

formojë një sanxhak nën një mytesarrif, i cili do ta këtë selinë në Pejë, por që do të jetë i varur nga vali i Vilajetit të Kosovës.

Ali pashë Gucia, njëri nga paria e shquar shqiptare, u emërua për mytesarrif i këtij sanxhaku të ri, me autorizim për t'i emëruar udhëheqësit shqiptarë si kajmakamë të pesë kazave nën jurisdikcionin e tij.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkrimi) J. E. BLUNT.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/119*, pp. 17.)

## 7. KONSULLI I PËRGJITHSHËM BLUNT KONTIT GRANVILLE

Im Lord,

Selanik, 12 tetor 1881

Në lidhje me shkresat e mia No. 111 dhe 114, të 27 shtatorit dhe të datës 4 të këtij muaji, që kanë të bëjnë me çështjen shqiptarë, kam nderin, që Shkëlqesisë Tuaj, t'ia dërgoj raportin, se pasha i Selanikut sot heret në mëngjes e mori një telegram zyrtar nga Prizreni me të cilin njohtohet se Dervish pasha dje në mëngjes marshoi prej Prizreni për në Dibër në krye të 20 batalioneve. Ushtria e Dervish pashës tani përbëhet krejtësisht prej ushtarëve të rregullt, pjesa më e madhe e të cilëve, nëse jo të gjithë, janë nga Anadulli. Trembëdhjetë prej batalioneve janë nga ushtria e Thesalisë dhe e Epirit, kurse pesë prej tyre janë nga divizioni i Shkodrës.

Po ashtu dëgjova se shqiptari i dalluar i Tetovës, Hasan pasha, ishte emëruar për mytesarrif të Sanxhakat të Prizrenit, në vend të Ferik Mehmet pashës, i cili ishte ftuar të kthehej për në Stamboll.

Dervish pasha shpreson se "gegët do t'i kënaqë dhe do t'i pajtojë duke e transferuar qeverinë civile të vendit në parinë e tyre, por mendoj se ky sistem i qeverimit heret a vonë do të bëhet i papërshtatshëm, ose do të gjendet në rrezik, sepse paria shqiptare është kapricioze dhe jo plotësisht besnike. Do të shtoja se as Ali pashë Gucia, së voni i emëruar për mytesarrif i Sanxhakat, të Pejës, e as Hasan pasha i lartpërmendur, nuk kanë pasur ndonjë përvojë qeverisjeje.

Haxhi Ymer efendiu, kryetar i Lidhjes, akoma gjendet në Ulqin. Ai kishte kërkuar azil të Qeveria Malazeze, të cilin, në të vërtetë, e fitoi. Familja e tij është ndalë në Selanik dhe ajo është nën mbikëqyrjen e policisë.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkruar) J. E. Blunt.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/119*, pp. 29.)

## 8. KONSULLI I PËRGJITHSHËM BLUNT KONTIT GRANVILLE

Im Lord,

Selanik, 30 tetor 1881

Kam nderin ta raportoj Zotërinë Tuaj se dy udhëheqës shqiptarë, Ali pasha nga Gucia, dhe Hasan pasha nga Tetova, të cilët para ca kohe u emëruan: i pari për mytesarrif të Pejës, dhe i dyti për mytesarrif të Prizrenit, arritën këtu, me trenin e djeshëm, nga Shkupi, dhe u nisën sot për në kryeqytet (Stamboll), me qëllim që t'i bëjnë nderime Lartëmadhërisë së Sulltanit.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkruar) J. E. Blunt.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/120*, pp. 16.)

## 9. KONSULLI I PËRGJITHSHËM BLUNT KONTIT GRANVILLE

Im Lord,

Selanik, 26 shkurt 1882

Lidhur me situatën rreth konflikteve në Vilajetin e Kosovës, ndjej kënaqësi ta njohtoj Zotërinë Tuaj se shumë çeta cubash shqiptare dhe bullgare (maqedone — S. R.), e kanë rrethuar kazanë e Shkupit, të Prishtinës, të Gilanit dhe të Kumanovës, e në afërsi të kufirit bullgar e serb, janë shpërndarë. Kam dëgjuar, po ashtu, nga njerëzit të cilët, tani vonë, e vizituan sanxhakun e Jeni Pazarit, të Prizrenit dhe të Dibrës, se shqiptarët gegë në këto krahina dhe në kazatë fqinje, d. m. th. në atë të Ohrit, të Pejës dhe të Gjakovës, janë të qetë dhe janë pajtuar sa për sy e faqe me planet administrative të Dervish pashës. Jam bindur se taksat, tani, janë paguar me rregull, se plaçkitja e kafshëve, gjakmarrja dhe padrejtësitë e tjera sociale, janë më të rralla, dhe se në përgjithësi autoriteti i ligjit ndihet më shumë dhe respektohet.

Por, informatorët e mi pohojnë se ky përmirësim i situatës mund të çrregullohet rastësisht nga kryengritja, që ka shpërthyer në krahinat kufitare të Bosnjës dhe të Hercegovinës; dhe ndonëse ata pranojnë se tani për tani nuk ka shenja të agjitacionit politik në këtë anë të kufirit, ata përsëri kanë frikë se shqiptarët do të zgjohen nga ndjenjat e tyre nacionale dhe fetare për të marrë pjesë në lëvizjen nëse ajo përhapet kah jugu.

Disa frikësime të tilla, po ashtu, i kanë kapluar edhe autoritetet ushtarake të Austro-Hungarisë në Sanxhakun e Jeni Pazarit, sepse unë e di me siguri se Gjenerali, në komandën e ushtrisë austriake në Taslixhë (Plevlë), tani vonë, në mënyrë sekrete i informoi autoritetet kufitare osmane, se një sasi e madhe e armëve, e de-

dikuar për kryengritësit në Hervegovinë, është fshehur nga paria shqiptare në qytetin e Mitrovicës. Gjithashtu do të shtoja se Dervish pasha pasi u largua nga Vilajeti i Kosovës, u kthye menjëherë këtu (në Selanik) pas shetitjes që bëri në sanxhakun e Dramës e të Serezit.

Siç jam informuar në mënyrë te plotë Dervish pasha erdhi me qëllim që të njohtohet me përmbajtjen e vërtetë të raportit të sipërm. Ai, në të njëjtën kohë, duke këshilluar se duhet kushtuar vëmendje serioze lajmeve të mytesarrifit të Jeni Pazarit, të Prizrenit dhe të Pejës, vuri në pah nevojën e kontrollimit me kujdes të kufirit me qëllim që të pengohen shqiptarët që të mos jenë në gjendje t'u japin asnjë ndihmë kryengritësve të Bosnjës dhe mos të kenë mundësi t'i frymëzojnë ata (kryengritësit) kundër sundimit austriak.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkruar) J. E. Blunt.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/136*, pp. 102, 103.)

#### 10. DISA VËSHTRIME PËR GJENDJEN E TANISHME TË DARDANISË (DUKE PËRFSHIRË VILAJETIN E KOSOVËS DHE NJË PJESË TË VILAJETIT TË MANASTIRIT) NGA ZOTËRI A. EVANS

Ndarja e sotme e vilajeteve në Shqipërinë e Epërme është fare artificiale dhe qartas e pakuptueshme. Kështu, derisa Shkupi dhe Prishtina u përfshinë në Vilajetin e Kosovës, krahinat fqinje dhe gjeografikisht të pandara të Tetovës (Kalkandelen) dhe të Prizrenit u vendosen në administrimin e largët të Manastirit!\* Kjo ndarje ka shumë gjasa të jetë bërë për qëllime ushtarake, sepse në rast se veprimtaria e lëvizjes shqiptare kalon në Sharr ushtria e dy vilajeteve mund të mposhtë atë pa ndonjë trazim të shpërndarjes normale të forcave. Por, po ashtu, te Porta mund të ekzistojë një frikë e natyrshme nëse një krahinë shumë të madhe shqiptare e vendos në komanden e një pashaje, i cili mund të përpiqet të luajë një lojë ambicioze. Ndonëse trazirat e reja, përta i përket çështjes së kufirit malazes, ishin lokale dhe kryesisht të kufizuara te malësorët katolikë të krahinës së Shkodrës, ato sigurisht kanë bërë jehonë në këtë anë të malit Sharr, prandaj, autoritetet osmane e panë të arsyeshme të dërgojnë disa batalione të tjera në Guci dhe në vende të tjera. Në momentin e tanishëm Lidhja Shqiptare mund të thuhet se nuk është aktive, por ka prova të qarta të vazhdimit të lëvizjes, gjë që kjo ishte një simptomë. Mund të thuhet me siguri se në Vilajetin e Kosovës dhe në krahinat fqinje të Dardanisë së Lashtë, kudo që elementi shqiptar mbizotëron autoriteti

\* Më 1880 Sanxhaku i Prizrenit u shkëput nga Vilajeti i Kosovës.

i pushtetit osman ekziston, por ai nuk ushtrohet. Bile edhe në Mytesarrifllëkun e Shkupit, pjesa më paqësore e vendit, autoritetet osmane nuk kanë guxim të futen në ndonjë prej katundeve malore pa u përkrahur prej një ushtrie të konsiderueshme. Këta malësorë shqiptarë janë të armatosur mirë, kryesisht me „Martini-Henry”, dhe ata vazhdimisht janë duke i tiranizuar të krishterët e tyre fqinjë; por, edhe pse ata paraqesin një rrezik eventual për Qeverinë Osmane, prapëseprapë asnjë orvajtje nuk është ndërmarrë për t’i çarmatosur. Zyrtarët lokalë osmanë, e kjo është një simptomë e rëndësishme, më shumë po e përkrahin vullnetin e tyre të mirë. Ata (turqit) (shqiptarë myslimanë — S. R.) po flasin me të madhe për tolerimin e idesë shqiptare për formimin e një shteti vasal nën sundimin e Sulltanit, dhe siç dëgjova zyrtarët osmanë (sigurisht shqiptarët myslimanë — S. R.), këtu, haptazi po e mallkojnë Dervish pashën, i cili me zënie tradhtisht të udhëheqësve shqiptarë në Shkup e shoi përkohësisht „Lidhjen”. Për më tepër duhet të mbahet në mend se derisa pashallarët, mytesarrifët dhe mydyrët janë duke u ndërruar vazhdimisht, nëpunësit e fesë myslimane rrinë *en permanence* (pa ndërprerje) në divane të konakut të Mexhllisit lokal dhe ushtrojnë kontroll më së real mbi administratën. Ky ndikim fetar mysliman ndihet në të gjitha anët e besimtarëve të vërtetë shqiptarë, dhe çdo funksionar i cili do ta injoronte atë do të vihet në lëvizje e gjithë maqinaria e intrigave, intriga këto që do të përhapen deri në Stamboll.

(...)

Korrik 1883

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/136*, pp. 142, 143.)

#### 11. KONSULLI I PËRGJITHSHËM BLUNT ZOTËRI WYNDHAIM-IT

Sër,

Selanik, 3 mars 1885.

Dërgimi i shpejtë i ushtrisë për në Prizren, për të cilën gjë iu njohtova telegrafikisht më 1 dhe 2 të këtij muaji, e vërtetoi shumë informatën e dërguar në telegramin tim të 15 të muajit të kaluar, lidhur me trazirat e parapara në këtë krahinë.

Duke mos arritur ende të siguroj një korrespondent të besueshëm në atë vend, me keqardhje them, nuk jam në gjendje për t’iu pajisur me informatë të përpikët nga vendi, përsa i përket ngjarjeve të zhvilluara, por, në këtë çast, dërgimi i shpejtë i ushtrisë plotësuese në atë drejtim, shkaktoi këtu shumë shqetësime si dhe ngjalli shumë thashethëne, në mes tjerash, se shqiptarët në Prizren janë ngritur në kryengritje të hapët.

Letra e bashkangjitur prej një zotërie të Shkupit (letra nga Shkupi mban dt. 27 shkurt 1885 — S. R.), i cili nga ndonjëherë më pajiste me informata për ngjarjet e zhvilluara në Vilajetin e Kosovës, hedh pak dritë për situatën në fjalë; por unë kuptova prej burimeve osmane se ngjarjet, për të cilat korrespondenti im referon në lidhje me shtuarjen e taksës bashkiake për importin dhe eksportin, nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me ngjarjet në Prizren, taksë kjo e cila e përfshin Vilajetin e Manastirit e jo atë të Kosovës.\*

Ushtritë e dërguara në Prizren dhe në Mitrovicë, brenda ditëve të fundit, janë:

Një batalion i këmbësorisë dhe një bateri e artillerisë në kuaj nga divizioni i Selanikut; dy batalione këmbësorie nga korparmata në Manastir.

Një batalion këmbësorie nga divizioni i Serfixhes.

Pastaj, siç ju telegrafova mbrëmë, e di sigurisht se shefi i hekurudhës së Selanikut ka marrë urdhër nga autoritetet ushtarake lokale për të përgatitur trene speciale për dërgimin edhe të dy batalioneve këmbësore dhe të një baterie të artillerisë për në Mitrovicë. Nuk di ende prej nga duhet të tërhiqen këto ushtri plotësuese.

Siç po vërej, të gjitha autoritetet situatën në Prizren e konsiderojnë si të rrezikshme dhe të vështirë, kështu që Qeveria Osmane nuk e ka lehtë t'i dalë në krye pa ndërmarrë aksion më energjik, i cili mund të shpjerë edhe deri te gjakderdhja.

Ata, mbi të gjitha, frikësohen se çdo trazim serioz në Shqipërinë e Epërme në këtë moment, komitetet politike lokale në Bullgari dhe në Rumelinë Lindore, mund ta shfrytëzojnë si rast të përshatshëm për ta nxitur kryengritjen në Maqedoni.

Po qe se frika e autoriteteve vërtetohet atëherë gjendja e kësaj krahine me të vërtetë do të vështirësohet. Mund të ndodhin ngjarje të mjerueshme, të ngjashme me ato që zunë vend në Bullgari më 1876, vetëm e vetëm pse mjetet ushtarake që autoritetet i kanë në dispozicion nuk do të mjaftojnë për t'u ballafaquar me rastet e papritura.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/60*, pp. 121.)

## 12. KONSULLI I PËRGGJITHSHËM BLUNT ZOTËRI WYNDHAM-IT

Sër,

Selanik, 16 mars 1885.

Kam nderin t'ia bashkangjes, për informimin e Juaj sa më të plotë, një fragment prej një letre të vonshme të një korrespondenti nga Jeni Pazari, i cili është në gjendje që të informohet mirë me ngjarjet e tanishme në atë krahinë.

\* Prizreni deri në vitin 1880 ishte në kuadrin e Vilajetit të Kosovës, e pastaj, iu bashkangjit Vilajetit të Manastirit.

Ai pohon se banorët e Jeni Pazarit, të cilët janë të gjithë bashnjakë, pjesërisht myslimanë e pjesërisht të krishterë, nuk i përkrahin dhe nuk kanë mirëdashje të madhe me shqiptarët. Gjithashtu në kufinj të austriakë dhe serbë mbretëron qetësia e përsosur.

Lajmet të cilat trimërojnë kanë mbërritur nga Prizreni: komunikimi telegrafik përsëri është vendosur me atë vend dhe ferik (gje-neral divizioni), Vejsel pasha, ka arritur atje me pjesën e ushtrisë së përqendruar në Ferizaj; konsujtë e jashtëm dhe banorët e krishterë nuk kanë përjetuar ndonjë të keqe. Në tërësi duket se me përdorimin e forcës u shtypën shqiptarët dhe se Porta njëmend ka vendosur të mbajë rregull dhe qetësi.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkruar) J. E. Blunt.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/60*, pp. 138).

### 13. KONSULLI I PËRGJITSHËM BLUNT ZOTËRI WYNDHAM-IT

Sër,

Selanik, 21 mars 1885.

Letrat e vonshme të marra këtu nga Prizreni tregojnë se në atë qytet mbretëron qetësia e plotë. Shumë kryengritës shqiptarë, të cilët ishin në afërsi të qytetit, u shpërndanë, meqë Vejsel pasha afrohej me ushtrinë e tij nga Ferizaji.

Kryengritësit u përpoqën që më 1 të këtij muaji ta pushtojnë qytetin, por ata i dëboi ushtria e garnizonit, të cilën e komandonte Ibrahim pasha. Kështu, pra, pas një përleshjeje të ashpër, e cila zgjati pesë orë, u vranë dhe u plagosën 300 veta.

Informata e sipërme është vërtetuar nga letrat të cilat kanë arritur nga kolegu im austriak, d. m. th. konsulata austriake në Prizren.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkruar) J. E. Blunt.

(The Public Record Office, London, *F. O. 424/61*, pp. 2.)

### 14. ZOTËRI KIRBY GREEN KONTIT GRANVILLE

Im Lord,

Shkodër, 26 mars 1885.

Përsa i përket raportit tim No. 5 të dt. 8 të këtij muaji, në lidhje me trazirat në rrethin e Prizrenit, kam nderin ta informoj Zotërinë Tuaj se autoritetet osmane këtu më informuan saktësisht,

siç kishin kuptuar edhe ata vetë, se ushtrisë perandorake i kishte shkuar përdore ta kthejë qetësinë e plotë në Prizren.

Në anën tjetër, mësova nga një burim i sigurt vendas, se qetësia lindi nga fakti se malësorët shqiptarë pjesën më të madhe të municionit të vet e kishin shpenzuar për armët me predha dhe se besimi i përgjithshëm në fuqinë e Qeverisë (Osmane) për të mbajtur rregull aq shumë është tundur sa që zejtaria dhe tregtia janë pezulluar plotësisht në mbarë Vilajetin e Kosovës.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkruar) W. KIRBY GREEN.

(The Public Record Office, London, *F. O. 421/61*, pp. 5.)

#### 15. KONSULLI I PËRGJITHSHËM BLUNT MARKIZIT TË SALISBURY-T

Im Lord,

Selanik, 16 gusht 1885.

Kam nderin t'ju raportoj Zotërisë Tuaj se raportet e publikuara tani vonë në disa gazeta evropiane për trazirat e shpërthyera në mes të kufitarëve grekë dhe osmanë nuk janë vërtetuar nga autoritet osmane e as nga korrespondentët e mi të terrenit në fjalë. Përkundrazi, jam i sigurt se gjendja në kufirin grek është përmirësuar shumë dhe se ushtritë greke bashkëpunojnë me ushtritë osmane në mbajtjen e rregullit dhe të qetësisë.

Zotëri zëvendës-konsulli Blakeney raporton se kryetari i bandidëve zëkeq, Apostolaki, është ndjekur tani vonë dhe është vrarë nga ushtarët osmanë dhe grekë.

Asnjë trazirë serioze nuk është shfaqur në këtë verë në rrethin e Katarinës, të Karaferisë (Veria) dhe të Kasandrës; dhe se zëvendëskonsujtë në Kavallë, në Dramë dhe në Serez, raportojnë se këto sanxhaqe janë mjaft të qeta. Disa cuba që u paraqiten, tani vonë, në Sanxhakun e Serezit janë ndjekur energjikisht dhe u likuiduan nga ushtritë osmane.

Në Vilajetin e Janinës e sidomos në atë të Manastirit, kusaria është akoma e shpeshtë. Para disa ditësh kusarët grekë e kidnapuan një zotëri italian dhe gruan e tij në afërsi të Mecovës, në Epir. Brenda dy muajve të fundit disa myslimanë e krishterë të pasur u shpunë nga cubat shqiptarë e bullgarë (ndoshta maqedonë — S. R.), në Florinë, në Koricë, në Prilep dhe në vise të tjera të Vilajetit të Manastirit.

Korrespondenti im në Vilajetin e Kosovës më informoi se çështja ende ekziston mu në afërsi të Bullgarisë dhe të Serbisë dhe se autoritetet osmane ankohen se ushtria në kufirin bullgaro-serb nuk po merr masa serioze për likuidimin e të ligës.

Në lidhje me gjendjen e punëve në Prizren, në Shqipërinë e Epërme, u njohtova nga ipeshkvi katolik i asaj krahine, gjatë qëndrimit të tij të vonshëm në Selanik, se shqiptarët e pakënaqur i frikësoi një fuqi e madhe (prej 8.000 burrash), e cila u përqëndrua atje me urdhërin e Vejsel pashës.

Ky gjeneral i arrestoi dhe i internoi për në Azi të Vogël udhëheqësit kryesorë të trazirës së fundit dhe pati sukses t'i detyrojë shqiptarët që të regrutohen për ushtri dhe t'i vjelë taksat e papaguara për Qeverinë Osmane.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkrimi) J. E. BLUNT.

(The Public Record Office, London, *F. O. 421/62*, pp. 19.)

#### 1. Mr. ST. JOHN TO EARL GRANVILLE.

(Telegraphic.)  
(Extract.)

Constantinople, January 15, 1881.

YOUR Lordship's despatch No. 4, Confidential, of the 6th instant.

